



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Doracak për Inaugurimin dhe Funksionalizimin e Organeve të Komunës



Hyrje

Në përputhje me vendimin e nxjerrë nga Presidentja e Republikës së Kosovës për shpalljen e zgjedhjeve lokale 2013, si dhe bazuar në mandatin ligjor për dhënien e këshillave dhe udhëzimeve ligjore për komunat, të përcaktuar në shtojcën XII të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), ka hartuar këtë “Doracak për Inaugurimin dhe Funkcionalizimin e Organeve të Komunave”, pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve lokale 2013”.

Qëllimi i këtij Doracaku, është përkrahja e Komunave të Republikës së Kosovës në konstituimin e organeve të komunës si dhe funksionalizimin e tyre, me qëllim të sigurimit të ofrimit të shërbimeve bazuar në legjislacionin e zbatueshëm për vetëqeverisje lokale si dhe legjislacionin sektorial, që ndërlidhet me kompetencat e komunave.

1. Procedura për organizimin dhe mbajtjen e mbledhjes inauguruese të Kuvendit të Komunës

Mbajtja e mbledhjes inauguruese e Kuvendit të Komunës është përcaktuar me nenin 42 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008).

- Mbledhja e parë inauguruese e kuvendeve të komunave mbahet brenda 15 ditëve nga data e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve¹. Mbledhja e parë inauguruese e Kuvendit të Komunës thirret nga Kryetari (aty ku është zgjedhur).
- Nëse Kryetari nuk e thërret mbledhjen inauguruese të Kuvendit të Komunës brenda afatit prej 15 ditësh, atëherë, mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës thirret nga anëtari më i vjetër i zgjedhur i Kuvendit të Komunës, brenda 15 ditëve nga dita kur kryetari i zgjedhur ka dështuar që ta thërret mbledhjen inauguruese.
- Nëse edhe anëtari më i vjetër për çfarëdo arsye nuk e thërret mbledhjen inauguruese të Kuvendit të Komunës brenda afatit prej 15 ditëve, mbledhja inauguruese mund të caktohet me iniciativë të shumicës së anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit të Komunës.
- Mbledhjet e Kuvendit të Komunës që mbahen para zgjedhjes së kryesuesit të kuvendit të komunës kryesohen nga anëtari më i vjetër i kuvendit të komunës që është i pranishëm në mbledhje.
- Anëtarët e kuvendit duhet të informohen për mbledhjen inauguruese dhe do të marrin ftesën për pjesëmarrje në të, së paku shtatë ditë pune para datës së mbajtjes së mbledhjes. Ata gjithashtu duhet të jenë të njoftuar për kohën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes inauguruese si dhe me rendin e ditës së mbledhjes.

¹Neni 42.1 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Kuorumi

Një ndër kriteret ligjore për mbajtjen e mbledhjes inauguruuese të Kuvendit të Komunës është edhe kuorumi. Në vijim është shtjelluar shkurtimisht procedura për vërtetimin e kuorumit²:

- Në fillim të mbledhjes, kryesuesi i mbledhjes (ose anëtari më i vjetër) i Kuvendit të Komunës konstaton kuorumin. Kuorumi për mbajtjen e mbledhjes përbëhet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës (p.sh. nëse Kuvendi i Komunës përbëhet nga 19 anëtarë shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 10 anëtar).
- Nëse eventualisht nuk ka kuorum për mbledhje, atëherë, mbledhja ndërprehet për shkak të mungesës së kuorumit dhe shtyhet për një datë tjetër.
- Mbledhja inauguruuese e Kuvendit të Komunës është e hapur për publikun.

Numri dhe zgjedhja e anëtarëve të kuvendit

Numri i anëtarëve në kuvendin e komunës të një komune është përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të nenit 36 duhet të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe duhet të jetë proporcional, varësisht nga numri i qytetarëve në komunë dhe atë:

- nëse komuna i ka deri në 10.000 qytetarë, kuvendi i asaj komune përbëhet prej 15 anëtarëve;
- nëse komuna i ka prej 10.001 deri 20.000 qytetarë, kuvendi i asaj komune përbëhet prej 19 anëtarëve;
- nëse komuna i ka prej 20.001 deri 30.000 qytetarë, kuvendi i asaj komune përbëhet prej 21 anëtarëve;
- nëse komuna i ka prej 30.001 deri 50.000 qytetarë, kuvendi i asaj komune përbëhet prej 27 anëtarëve;
- nëse komuna i ka prej 50.001 deri 70.000 qytetarë, kuvendi i asaj komune përbëhet prej 31 anëtarëve;
- nëse komuna i ka prej 70.001 deri 100.000 qytetarë, kuvendi i asaj komune përbëhet prej 35 anëtarëve;

² Neni 46 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Doracak për Inaugurimin dhe Funkcionalizimin e Organeve të Komunës

- nëse komuna i ka më shumë se 100.000 qytetarë, kuvendi i asaj komune përbëhet prej 41 anëtarëve dhe Kuvendi i komunës së Prishtinës përbëhet prej 51 anëtarëve.

Votimi

Procesi i i votimit është percaktuar në pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 48, si në vijim:

- Në të gjitha takimet e kuvendit të komunës dhe komitetet e tij, çdo person, përfshirë edhe kryesuesin, ka nga një votë, por kryesuesi ka një votë shtesë nëse votimi është i barabartë për ose kundër një propozimi.
- Nëse ndryshe nuk parashihet shprehimisht në këtë ligj, vendimet e kuvendit të komunës aprovohen me shumicën e anëtarëve që janë të pranishëm dhe votojnë.
- Abstenimet regjistrohen me qëllim të themelimit të kuorumit, por nuk merren parasysh në rezultatet e votimit.

Procesverbali

Nga të gjitha takimet e kuvendit të komunës dhe komisioneve të tij, në pajtim me Ligjin për përdorimin e gjuhëve, mbahen Procesverbalet dhe aprovohen në takimin e ardhshëm³.

³Neni 49 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

2. Procedura për dhënien e betimit të anëtarëve të kuvendeve të komunave si dhe kryetarëve të komunave

Betimi i anëtarëve të Kuvendeve të komunave

Dhënia e Betimit të anëtarëve të Kuvendeve të Komunave është përcaktuar në nenin 35 pika 4 dhe pika 5 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

- Në mbledhjen inauguruese të Kuvendit të Komunës, anëtarët e kuvendit të komunës japin betimin dhe nënshkruajnë deklaratën solemne. Anëtari më i vjetër i udhëheq dhënien e betimit nga të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës. Në rast të mungesës së ndonjërit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës dhënia e betimit bëhet në mbledhjen e radhës së Kuvendit të Komunës⁴.

Bazuar në nenin 35 pika 5 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet ta nënshkruajnë betimin solemn si në vijim.

Unë, _____, “betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do ti ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së _____, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

Vendi _____

Datë, __ dhjetor 2013

Pushimi i mandatit të anëtarit të kuvendit të komunës për shkak të mos nënshkrimit të betimit

Anëtarët e Kuvendit të Komunës të cilët nuk e nënshkruajnë betimin ose mandatin e tyre brenda një muaji pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pushojnë së qeni anëtarë të Kuvendit të Komunës.

Anëtari i kuvendit të komunës në të njëjtën kohë nuk mund të jetë deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës⁵, pjesëtar i shërbimit civil të Republikës së Kosovës ose në ndonjë pozitë tjetër që është përcaktuar me ndonjë ligj të veçantë.

⁴Njëmostër e tekstittëbetimitështëofruarnështojcat e këtijUdhëzuesi.

⁵Neni 73.3 i KushtetutëssëRepublikëssëKosovës.

Betimi i Kryetarit të Komunës

Dhënia e Betimit të Kryetarit të Komunave është përcaktuar në nenin 57 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Me rastin e zgjedhjes, kryetari i komunës jep betimin ose deklaratën solemne para anëtarëve të Kuvendit të Komunës. Procedura e betimit udhëhiqet nga Kryesuesi i ri i Kuvendit të Komunës, ndërsa nëse ai ende nuk është zgjedhur, atëherë procedurën e betimit të Kryetarit të Komunës udhëheq anëtari më i vjetër i kuvendit të komunës, në cilësinë e kryesuesit të mbledhjes. Nga momenti i dhënies së betimit Kryetari i sapozgjedhur ushtron të gjitha funksionet dhe kompetencat sipas ligjit.

Bazuar në nenin 57 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, me rastin e zgjedhjes, Kryetari i komunës jep betimin ose deklaratën solemne para anëtarëve të Kuvendit të Komunës, si në vijim.

Unë, _____, "betoem (ose deklaroj solemnisht) që do t'i kryej detyrat dhe do t'i ushtrojë kompetencat si kryetar i komunës së _____, me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që t'i siguroj kushte për një jetë të qetë për të gjithë".

Vendi _____

Datë, __ dhjetor 2013

3. Procedura e zgjedhjes së Kryesuesit të Kuvendit të Komunës

Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës është përcaktuar në nenin 41 të Ligjit Nr.03-L/040 për Vetëqeverisje Lokale,(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008).Procedura për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës sipas dispozitave të nenit 41 të LVL-së është rregulluar si në vijim:

- Bazuar në paragrafin 1 të nenit 41 të LVL-së, kuvendi i komunës e zgjedh Kryesuesin e Kuvendit të Komunës nga radhët e anëtarëve;
- Sipas paragrafit 2 të nenit 41 të LVL-së Kryesuesi i Kuvendit të Komunës zgjidhet për një mandat të njëjtë sikurse anëtarët e kuvendit;
- Sipas paragrafit 3 të nenin 41 të LVL-së, Votimi për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës bëhet me vota të fshehta;
- Sipas paragrafit 4 të nenin 41 të LVL-së për tu zgjedhur në votimin e parë, kandidati duhet të marrë më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur;
- Sipas paragrafit 5 të nenin 41 të LVL-së në rast se në votimin e parë asnjëri prej kandidatëve nuk e siguron shumicën e kërkuar, atëherë dy kandidatë me numrin më të madh të votave shkojnë në votimin e dytë. Kandidati që merr më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur do të zgjidhet Kryesues i Kuvendit të Komunës;
- Sipas nenit 3 të Udhëzimit Administrativ Nr. 2009/01 për Procedurën e Zgjedhjes dhe Përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, nëse edhe pas votimit të dytë asnjëri nga kandidatët e propozuar nuk ka fituar shumicën e kërkuar atëherë shkohet në votimin e tretë. Në votimin e tretë kryesues i Kuvendit të Komunës zgjedhet kandidati i cili merr më shumë se gjysmën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë, për propozimin në mbledhjen e Kuvendit të Komunës;
- Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit bëhet brenda 30 ditëve pas themelimit. Kuvendi i Komunës sipas nenit 50.2 (a) i LVL-së, konsiderohet jo funksional nëse nuk e zgjedh Kryesuesin 30 ditë pas themelimit.

4. Procedura e zgjedhjes së Zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete

Zgjedhja e Zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës është përcaktuar në nenin 54 të Ligjit Nr.03-L/040 për Vetëqeverisje Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/ 2008).Procedura për zgjedhjen e zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës sipas dispozitave të nenit 54 të LVL-së është rregulluar si në vijim:

- Në komunat ku së paku 10 % e qytetarëve i takojnë komuniteteve joshumicë, posti i zëvendëskryesuesit të kuvendit të komunës rezervohet për përfaqësuesin e këtyre komuniteteve. Postin e zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës për komunitetet e mban përfaqësuesi i popullatës joshumicë, që ka marr më shumë vota në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhje në Kuvendin e komunës.

Përgjegjësitë e zvendëskryesuesit të kuvendit të komunës ndërlidhen me:

- Promovimin dhe afirmimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve joshumicë të cilat trajtohen edhe në mbledhjet e Kuvendit të komunës;
- Shqyrtimin e ankesave të komuniteteve joshumicë duke u siguruar që aktet e komunës të mos shkelin të drejtat e komuniteteve të garantuar me kushtetutë dhe ligj.
- Në rast se është evidentuar ndonjë akt i komunës në kundërshtim me Kushtetutë apo ligjin, kërkon nga Kuvendi i Komunës rishqyrtimin e tijë.
- Në rast të mos rishqyrtimit nga Kuvendi i Komunës apo konsiderohet se akti ende paraqet shkelje të të drejtave të komuniteteve të garantuara me kushtetutë zëvendëskryesuesi i Kuvendit të Komunës mund të parashtrojë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese e cila mund të vendosë për pranimin e çështjes për shqyrtim.

5. Procedura e zgjedhjes së Nënkryetarit të Komunës

Emërimi i Nënkryetari të Komunës është përcaktuar në nenin 60 të Ligjit Nr.03-L/040 për Vetëqeverisje Lokale,(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008).Procedura për emërimin e Nënkryetarit të Komunës sipas dispozitave të nenit 60 të LVL-së është rregulluar si në vijim:

- Bazuar në paragrafin 1 të nenit 60 në çdo komunë, Kryetari i Komunës ka një nënkryetar;
- Sipas paragrafit 2 të nenit 60, Nënkryetari emërohet nga kryetari për mandat të njëjtë si të Kryetarit të Komunës dhe shkarkohet nga Kryetari;
- Sipas paragrafit 3 të nenit 60, me kërkesëtë kryetarit, Nënkryetari i ndihmon kryetarit në ushtrimin e funksioneve ekzekutive të përditshme dhe vepron në emër të Kryetarit në mungesë të tij;
- Sipas paragrafit 4 të nenit 60, kur posti i nënkryetarit mbetet i lirë, kryetari emëron nënkryetarin e ri, jo më vonë se tridhjetë ditë pas paraqitjes së postit të lirë;

6. Procedura e zgjedhjes së Nënkryetarit të Komunës për Komunitete

Emërimi i Nënkryetari të Komunës për Komunitete është përcaktuar në nenin 61 të Ligjit Nr.03-L/040 për Vetëqeverisje Lokale,(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/ 2008). Procedura për emërimin e Nënkryetarit të Komunës për Komunitete sipas dispozitave të nenit 61 të LVL-së është rregulluar si në vijim:

- Bazuar në paragrafin 1 të nenit 61 komunat ku të paktën 10% e qytetarëve i përkasin komuniteteve jo shumicë do të kenë një nënkryetar për komunitete;
- Sipas paragrafit 2 të nenit 61, Nënkryetari për Komunitete emërohet për mandat të njëjtë si të Kryetarit të Komunës;
- Sipas paragrafit 3 të nenit 61, emërimi dhe shkarkimi i Nënkryetarit për Komunitete propozohet nga Kryetari i Komunës dhe duhet të miratohet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë si dhe shumica

e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë të cilët i përkasin komuniteteve jo shumicë;

- Sipas paragrafit 4 të nenit 61, Nënkyetari për Komunitete do t'i ndihmojë Kryetarit dhe do të ofrojë këshilla dhe udhëzime për kryetarin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me komunitetin pakicë;
- Sipas paragrafi 5 të nenit 61, kur posti i nënkryetarit për komunitete mbetet i lirë, kryetari propozon nënkryetarin e ri, jo më vonë se tridhjetë ditë pas paraqitjes së postit të lirë sipas procedurave të parapara në paragrafin 3 të këtij neni;

7. Procedura e deklarimit të pasurisë pas marrjes së mandatit

Në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-050 Për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë, zyrtarët publik të komunave janë të obliguar që pas marrjes së detyrës të deklarojnë pasurinë e tyre, bazuar në format e përcaktuara me ligj, të cilat janë përshkruar në vijim.

3.1 Deklarimi pas marrjes së detyrës zyrtare

Zyrtarët publikë në nivelin lokal duke përfshirë, Kryetarin e Komunës, Nënkyetarët e Komunës, Kryesuesin e Kuvendit të Komunës, Zëvendës-kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Anëtarët e Kuvendit të Komunës, Anëtarët e Bordeve të Ndërmarrjeve Publike dhe drejtorët e drejtorive komunale të emëruar pas marrjes së detyrës deklarojnë pasurinë ekzistuese, burimin dhe detyrimet brenda afatit tridhjetë ditor, ashtu siç është përcaktuar në nenin 5 të Ligjit Nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë. Deklarimi i pasurisë së zyrtarëve të lartë publik të komunës, paraqitet në Agjencinë Kundër Korrupsionit nga vetë zyrtari i lartë publik apo nga personat e autorizuar nga ai.

Deklarimi pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni

Pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni publik, zyrtari i lartë publik brenda tridhjetë ditëve paraqet deklarimin e pasurisë ashtu siç është paraparë me këtë Ligj.

Deklarimi i rregullt vjetor

Deklarimi i rregullt vjetor i pasurisë nga Zyrtari i lartë publik bëhet gjatë tërë kohës së ushtrimit të funksionit publik nga data 1 mars deri me 31 mars të çdo viti kalendarik.

Deklarimi sipas kërkesës së AKK

Agjencia në çdo kohë mund të kërkojë nga zyrtari i lartë publik që të dorëzoj informacione rreth deklarimit të pasurisë.

Kufizimet e zyrtarëve publikë në pranimin e dhuratave

Personi zyrtar nuk mund të kërkojë ose të pranojë dhurata ose favore të tjera për vete as për anëtarët e familjes, në lidhje me ushtrimin e detyrave zyrtare të cilat ndikojnë dhe që mund të ndikojnë në ushtrimin e detyrave zyrtare, përveç dhuratave protokollare dhe dhuratave të rastit.

Për më tepër, zyrtari nuk mund të marrë më shumë se një dhuratë në vit nga i njëjti person apo institucion, ndërsa personat zyrtarë nuk mund të pranojnë dhurata monetare në asnjë rast.

Të gjitha dhuratat e pranuar dhe vlera e tyre përkatëse, si dhe emrat e personave që kanë dhënë dhuratën, duhet të regjistrohen në regjistrin e dhuratave nga personi zyrtar që përcaktohen nga Agjencia kundër Korrupsionit dhe që mbahen nga institucioni, në të cilën personi zyrtar ushtron detyrën.

8. Procedura e themelimit të komiteteve obligative

Themelimi i komiteteve të përhershme është përcaktuar në nenin 51 të Ligjit Nr.03-L/040 për Vetëqeverisje Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008). Kuvendet e komunave janë të obliguara të themelojnë dy komitete të përhershme: Komitetin për politikë dhe financa dhe Komitetin për komunitete.

- Bazuar në paragrafin 1 të nenit 52 të LVL-së, Komiteti për politik dhe financa, kryesohet nga kryesuesi i kuvendit të komunës dhe përbërja e tij duhet të reflektojë përfaqësimin e entiteteve politike në kuvendin e komunës;
- Sipas paragrafit 2 të nenit 52 të LVL-së, Komiteti për politik dhe financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifatat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në kuvendin e komunës;
- Bazuar në paragrafin 1 të nenit 53 të LVL-së, Komiteti për komunitete përfshinë në radhët e veta shumicën e thjeshtë nga anëtarët e kuvendit të komunës, anëtarët e tjerë janë përfaqësuesit e komuniteteve. Çdo komunitete që jeton në komunë përfaqësohet nga së paku një përfaqësues në komitetin për komunitete. Përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë në komunë e përbëjnë shumicën e anëtarëve të komitetit për komunitete;
- Sipas paragrafit 2 të nenit 53 të LVL-së, Komiteti për komunitete është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për tu siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon kuvendit të komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor si dhe për të siguruar mbrojtje adekuata të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

9. Funkcionalizimi i Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi

Themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (më tutje KKSB) është obligim ligjor i përcaktuar me nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.19 /2012).Procedura e themelimit dhe funksionalizimit të KKSB-së është e rregulluar me Udhëzimin Administrativ Nr. 27/2012MPB-03/2012MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi - KKSB-së (më tej U.A për KKSB).

Për të funksionalizuar Këshillin për Siguri në Bashkësi, duhet të përmbushen obligimet themelore të mëposhtme:

- KKSB themelohet me vendim nga Kuvendi i Komunës sipas nenit 3.2 të U.A dhe përbërjes së përcaktuar me nenin 4 të U.A. për KKSB;
- Pas certifikimit të rezultateve zgjedhore, konstituimit të Kuvendit të Komunës dhe zgjedhjes së kryetarit të komunës, Kryetari i komunës përmes mediave publike ftonkomunitetet përkatëse për të bërë propozimet e anëtarëve të tyre në KKSB, ashtu siç është përcaktuar me nenin 9.1.1. të U.A. për KKSB;
- Lista me propozimet e komuniteteve përkatëse për anëtarë të KKSB-së miratohet në Kuvendin e Komunës, sipas nenit 9.1.2. të U.A. për KKSB;
- Kryetari i Komunës caktonnjë zyrtar komunal koordinator të takimeve të KKSB-së, ashtu siçështë përcaktuar me nenin 9.1.3 të të U.A. për KKSB;
- KKSB kryesohet nga kryetari i Komunës sipas nenit 8.1 të U.A. për KKSB;
- KKSB miratonPlanin Vjetor të Punës dhe zhvillimin e projekteve për rritjen dhe përmirësimin e sigurisë në bashkësi, sipas nenit 6.1. të U.A.për KKSB;
- Plani Vjetor i Punës prezantohet për miratim në Kuvendin e Komunës sipas nenit 9.1.7 të U.A. për KKSB;
- KKSB mbantakimet e rregullta sipas nenit 11 të U.A. për KKSB;
- Për anëtarë në KKSB të merren parasysh kriteret e përfaqësimit gjinor dhe përfaqësimin e drejtë të të gjitha bashkësive etnike, sipas nenit 7.3 të U.A. për KKSB.

Shtojcë:

- Ftesa e mbledhjes inauguruese;
- Rendi i ditës i propozuar për mbledhjen inauguruese;
- Formulari i nënshkrimit të betimit të anëtarit të Kuvendit të komunës;
- Formulari i nënshkrimit të betimit të Kryetarit të Komunës;
- Formulari për deklarimin e pasurisë.



Logo e Komunës

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

FTESE

Të nderuar anëtarë/e të Kuvendit të Komunës,

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e parë inauguruuese të Kuvendit të Komunës së _____, e cila do të mbahet me datë __ Dhjetor 2013.

Gjithashtu, Ju njoftoj se me këtë rast do të bëni betimin dhe do të nënshkruani deklaratën solemne për marrjen e detyrës së anëtarit të Kuvendit të Komunës së _____.

Ceremonia fillon në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës, në _____.

Të bashkangjitur me ftesën gjeni edhe rendin e ditës.

Ju mirëpresim,
Me respekt,

Emri dhe Mbiemri
Kryetari i zgjedhuri Komunës së _____



Logo e Komunës

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Rendi i ditës i propozuar për mbledhjen inauguruese

__ dhjetor 2013, 10:00 - 11:30

10:00 - 10:15	Arritja dhe nënshkrimi i anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe pjesëmarrësve tjerë
10:15 - 10:30	Fjala mirëseardhëse e Anëtarit më të vjetër të Kuvendit të Komunës <ul style="list-style-type: none">▪ Fjala mirëseardhëse
10:30-10:45	Kryesimi i mbledhjes nga anëtari më i vjetër i Kuvendit të Komunës <ul style="list-style-type: none">• Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës• Dhënia e betimit të Kryetarit të Komunës (nëse është zgjedhur)
10: 45 - 11:00	<ul style="list-style-type: none">• Fjala përshëndetëse e kryetarit të komunës (nëse është zgjedhur)
11: 00 - 11:15	Mbyllja e seancës



Logo e Komunës

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Bazuar në nenin 35.5, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet ta nënshkruajnë betimin solemn si në vijim.

Unë, _____, “betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do ti ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së _____, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

Emri dhe mbiemri i Anëtarit të Kuvendit të Komunës së _____,



Logo e Komunës

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Bazuar në nenin 57 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, me rastin e zgjedhjes, Kryetari i komunës jep betimin ose deklaratën solemne para anëtarëve të Kuvendit të Komunës, si në vijim.

Unë, _____, "betohem (ose deklaroj solemnisht) që do t'i kryej detyrat dhe do t'i ushtrojë kompetencat si kryetar i komunës së _____, me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që t'i siguroj kushte për një jetë të qetë për të gjithë".

Vendi _____

Datë, __ dhjetor 2013

Emri dhe mbiemri i Kryetarit të Komunës së _____,



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Agjencia kundër Korrupsionit
Agjencia protiv Korupcije/Anti-Corruption Agency

Nr. AKK

FORMULAR
PËR DEKLARIMIN E PASURISË

Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë (nr. 04/L-050), obligon të gjithë zyrtarët e lartë publik që me marrjen e detyrës të deklarojnë gjendjen e pasurisë së tyre në Agjencinë Kundër Korrupsionit. Gjithashtu ky ligj detyron zyrtarët e lartë publik që ta bëjnë deklarimin e pasurisë së tyre edhe në rastet kur Agjencia bënë kërkesë të tillë.

- Deklarimi me marrjen e detyrës, duhet të bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve (neni 7 i Ligjit Nr. 04/L-050).
- Deklarimi sipas kërkesës së Agjencisë (neni 9 i Ligjit Nr. 04/L-050).

Formulari duhet të plotësohet në mënyrë elektronike ose me shkrim (me shkronja të mëdha të shtypit).

Nëse hapësira e ndonjë rubrike nuk është e mjaftueshme, kopjoje dhe vazhdoni të plotësoni atë. Të gjitha rubrikat e formularit duhet të plotësohen, në të kundërtën formulari nuk do të pranohet në Agjenci.

Të dhënat e deklaruara publikohen në ueb faqen e AKK-së www.akk-ks.org me përjashtim të rubrikave të hijezuara.

Komuna është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Kosovë, e përbërë nga qytetarët e komuniteteve në një territor të caktuar të përcaktuar me ligj, siç parashihet në Ligjin Nr. 03/L-041 Për Kufijtë Administrativ të Komunave.

Komuna ka statusin e përsônit juridik, e cila ka kompetenca, të padisë dhe të paditet në gjykata, të posedojë dhe të menaxhojë me pasurinë.

Përdorimi i gjuhëve zyrtare në komunë rregullohet me Ligjin Nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve. Gjuhë zyrtare në tërë territorin e Kosovës është gjuha shqipe dhe gjuha serbe. Komunat nxjerrin rregullore të hollësishme komunale për përdorimin e gjuhëve brenda territorit të komunës, ashtu siç është përcaktuar me ligjin e përdorimit të gjuhëve.

Menaxhimi i Pronës - Komunat mbajnë dhe udhëheqin regjistrin e pronës së luajtshme dhe të paluajtshme. Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme Kuvendet e Komunave mund të japin pronën komunale në shfrytëzim afatshkurë dhe afatgjatë duke u bazuar në interesin publik të komunës, që ndikon në zhvillimin ekonomik lokal dhe rritjen e vlerës së saj. Procedura e hollësishme e dhënies së pronës komunale në shfrytëzim është rregulluar me këtë ligj dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij.

Parimet e funksionimit të vetëqeverisja lokale në Kosovë

Vetëqeverisja lokale ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura në zgjedhje të barabarta, të lira e të drejtpërdrejta. Veprimtaria e organeve të Komunës është e bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligjet e Kosovës si dhe Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale.

Vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e përcaktuara si më poshtë:

- Parimin e kushtetutshmërisë - harmonizimi i të gjitha akteve juridike me Kushtetutën;
- Parimin e ligjshmërisë - harmonizimi i të gjitha akteve dhe veprimeve të ndërmarra nga organet komunale me ligjin;
- Parimin e qeverisjes së mirë - vullneti dhe aftësia e organeve të komunës që ta përfshijë publikun në procese vendimarrëse dhe ti ofrojë shërbime efektive;
- Parimin e transparencës - është element përbërës i demokracisë lokale dhe u ndihmon qytetarëve të kenë qasje në punët publike, komunikim të drejtpërdrejtë me autoritetet lokale, si dhe të kërkojë llogaridhënie dhe përgjegjësi nga organet e komunës në ofrimin e shërbimeve dhe shfrytëzimin e burimeve;
- Parimin e efikasitetit dhe efektivitetit - ofrimi i shërbimeve publike në mënyrë të shpejtë, të sukseshme dhe cilësore, si dhe aftësia e autoritetetve të komunës për të zgjedhur mënyrën më të përshtatshme, si dhe

- Parimin e subsidiaritetit – çështjet publike realizohen, sa më shumë që të jetë e mundur, në interes të qytetarëve nga niveli më i ulët i qeverisë që është në gjendje të ofrojë shërbime efikase.

2. Kompetencat e Komunave

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqverisje Lokale në Kosovë, Komunitat ushtrojnë kompetencat vetanake, të deleguara dhe të zgjeruara.

Kompetencat vetanake - Komunitat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm, në fushat që vijojnë:

- zhvillimin lokal ekonomik;
- planifikimin urban dhe rural;
- shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin;
- zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit;
- mbrojtjen e mjedisit lokal;
- ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehtë lokale;
- përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale;
- ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trainimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit;
- promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
- ofrimin e përkujdesit publik primar shëndetësor;
- ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi për të cenueshmit, strehimin familjar, përkujdesin fëmijor, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e rrogave dhe trainimin e profesionistëve të mirëqenies sociale;
- banimin publik;
- shëndetësinë publike;
- licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportimin lokal publik dhe taksitë;
- emërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapsirës publike;
- turizmit;
- aktivitetet kulturore dhe të lira;

- çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre, apo që nuk i është parcaktuar një autoriteti tjetër;

Kompetencat e deleguara

Autoritetet qendrore në Republikën e Kosovës u delegojnë përgjegjësi komunave, në pajtim me ligjin, për kompetencat vijuese:

- shënimet kadastrale;
- regjistrimin civil;
- regjistrimin e votuesëve;
- regjistrimin e biznesit dhe licencimin;
- distribuimin e pagesave të ndihmës sociale (me përjashtim të pensioneve);
- mbrotja e pyjeve që ndodhen në territorin e komunës në kuadër të autorizimeve të deleguara nga autoriteti qendror, duke përfshirë edhe dhënien e licencave për prerjen e drunjve në bazë të rregullave të miratuara nga Qeveria;

Autoritetet qendrore në Republikën e Kosovës mund t'u delegojnë kompetenca shtesë komunave, nëse është e nevojshme, në pajtim me ligjin. Kompetencat e deleguara duhet, në të gjitha rastet, të shoqërohen me financim të nevojshëm në përputhje me objektivat, standardet dhe kërkesat e përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Kompetencat e zgjeruara komunale

Disa komuna, për të cilat jepet shpjegim më poshtë, kanë kompetencat e tyre të zgjeruara vetanake në fushën e shëndetësisë, edukimit dhe do të kenë të drejtë për të marrë pjesë në zgjedhjen e komandantëve të stacioneve policore, siç përcaktohet në nenet që vijojnë.

Autoritetet qendrore në Republikën e Kosovës monitorojnë ushtrimin e kompetencave të zgjeruara në pajtim me legjislacionin qendror, që parashih qasje të barabartë në shërbimet publike; standarde minimale sasiore dhe cilësore në ofrimin e shërbimeve publike; kualifikime minimale të personelit dhe trainimit të tyre, parimet e përgjithshme për licencim dhe akreditim të ofruesëve të shërbimeve publike.

Komunat që ushtrojnë kompetenca të zgjeruara komunale mund të bashkëpunojnë me çdo komunë në ofrimin e shërbimeve të tilla.

Kompetencat e zgjeruara në përkujdesin dytësor shëndetësor

Komuna e Mitrovicës së Veriut, Graçanicës dhe Shtërpcës kanë kompetenca për ofrimin e përkujdesit dytësor shëndetësor, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve të përkujdesit shëndetësor, punësimin, pagesën e rrogave dhe trainimin e personelit dhe administratorëve të përkujdesit shëndetësor.

Kompetenca të zgjeruara në shkollimin universitar

Komuna e Mitrovicës së Veriut ka kompetencë për shkollim të lartë, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve shkollore, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve arsimor.

Kompetencat e zgjeruara në fushën e kulturës

Të gjitha komunat, në të cilat komuniteti serb është shumicë, kanë kompetenca për të ushtruar përgjegjësitë për çështjet kulturore, duke përfshirë mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe religjioze serbe dhe të tjerëve, brenda territorit komunal, si dhe për mbështetjen e komunitetve lokale religjioze, në pajtim me ligjin në zbatim. Komunat mund të bashkëpunojnë me çdo komunë tjetër në çështjet kulturore.

Të drejta të zgjeruara për pjesëmarrje në zgjedhjen e komandantëve të stacioneve policore lokale

Komunat, në të cilat komuniteti serb është shumicë, kanë kompetenca për të ushtruar të drejta të zgjeruara për pjesëmarrje në zgjedhjen e komandantit lokal, sipas ligjit për policinë.

3. Kompetencat e Kuvendit të Komunës

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë komunal dhe me qëllim të ushtrimit të funksioneve dhe përgjegjësisë ligjore i njëjti pas konstituimit ndërmerr veprimet në vijim:

Doracak për Inaugurimin dhe Funkcionalizimin e Organeve të Komunës

- Zgjedh kryesuesin e Kuvendit të Komunës jo më vonë se 30 ditë pas konstituimit;
- Në komunat ku së paku 10% e qytetarëve u takojnë komuniteteve jo-shumicë, posti i zëvendës kryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete rezervohet për një përfaqësues të këtyre komuniteteve;
- Themelon Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete si komitete të përhershme.
- Themelon komitete të tjera për të cilat konsideron se janë të nevojshme për kryerjen e përgjegjësive të tyre.
- Themelon komitete këshillëdhënëse sektoriale me qëllim nxitjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe marrjes së këshillave për kryerjen e funksioneve të veta ligjore.
- Themelon Komisionin Vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim;
- Themelon Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi;
- Emëron nënkryetarin e komunës për komunitete me shumicën e votave të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, në komunat ku të paktën 10 % e qytetarëve i përkasin komuniteteve jo-shumicë;
- Miraton aktet normative komunale për zbatimin e përgjegjësive ligjore:
 - Statutin e Komunës,
 - Rregulloren e Punës së Kuvendit;
 - Rregullore të ndryshme për fushat e përgjegjësive që i ka, dhe
 - Vendime.
- Miraton buxhetin e komunës dhe planet investuese;
- Miraton çështje të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për kuvendin sipas statutit apo rregullores së punës;
- Miraton planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
- Miraton iniciativat e bashkëpunimit ndër komunal;
- Përcakton nivelin e tarifave dhe ngarkesave
- krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- Emëron dhe riemëron rrugët, rrugicat dhe vendet tjera publike;
- Miraton vendimet për bashkëpunimin ndër-komunale;
- Merr vendime për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës
- Rishqyrton kërkesat e autoritetit mbikëqyrës, lidhur me aktet komunale të cilat niveli qendror i konsideron se nuk janë të harmonizuar me legjislacionin për vetëqeverisje lokale dhe legjislacionin sektorial primar;

- Trajton çështje tjera që janë në kompetencë të kuvendeve komunale, në pajtim me legjislacionin për vetëqeverisje lokale dhe ligjet sektoriale, e të cilat ndërlidhen me mandatin ligjor të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjet e kuvendit të komunës

Kuvendi i Komunës mban së paku dhjetë seanca në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë muajve të parë të vitit, siç përcaktohet me Rregulloren e Punës. Të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës duhet të njoftohen paraprakisht me shkrim, ashtu siç kërkohet, shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Njoftimi dhe materialet e mbledhjes duhet të respektojnë Ligjin mbi Gjuhët.

Mosfunksionimi i kuvendeve të komunave

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, kuvendet e komunave mund të konsiderohen jofunksionale në rast se nuk u përmbahen obligimeve ligjore në vijim:

- nuk e zgjedh kryesuesin, tridhjetë (30) ditë pas themelimit;
- nuk miraton statutin e komunës brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh pas themelimit (konstituimit);
- nuk miraton buxhetin sipas afatit të paraparë me ligjin përkatës; ose
- nuk mban mbledhje për një periudhë më të gjatë se gjashtë (6) muaj.

Doracak për Inaugurimin dhe Funksonalizimin e Organeve të Komunës

Kryetari i komunës zgjedhet me zgjedhje të drejtpërdrejta në pajtim me ligjin mbi zgjedhjet lokale. Kryetari i komunës zgjidhet për një periudhe katër vjeçare.

Me qëllim të ushtrimit të funksioneve dhe përgjegjësi ligjore pas zgjedhjes, Kryetari i Komunës ushtron kompetencat në vijim:

- Përfaqëson komunën dhe vepron në emër të saj;
- Ka të drejtë të nxjerrë urdhëresa dhe vendime brenda fushës së kompetencave të tij.
- Udhëheqë ekzekutivin e komunës dhe administratën komunale dhe mbikëqyr administrimin financiar të komunës;
- Ekzekuton aktet e Kuvendit të Komunës;
- Emëron nënkryetarin e komunës;
- Propozon Nënkryetarin e Komunës për Komunitete në komunat ku të paktën 10 % e qytetarëve u përkasin komuniteteve joshumicë;
- Emëron drejtorët e drejtorive komunale ose konfirmon drejtorët aktual;
- Propozon rregullore, plane rregullutive, zhvillimore dhe investuese, dhe buxhetin vjetor për miratim në Kuvendin e Komunës;
- Raporton para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomike-financiare të komunës dhe planeve investuese së paku një (1) herë në gjashtë muaj apo në çdo kohë kur kërkohet nga Kuvendi;
- Mund të kërkojë nga Kuvendi i Komunës të shqyrtojë një akt komunal para hyrjes në fuqi, kur konsideron se akti cënon legjislacionin në zbatim apo interesin e qytetarëve dhe komuniteteve;
- Është përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të pronës së luajtshme dhe të paluajtshme të komunës në shfrytëzim;
- Propozon tre (3) anëtar nga ekzekutivi i komunës për Komisionin vlerësues të dhënies së pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim;
- Kryeson Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi;
- I dërgon autoritetit mbikëqyrës listën e të gjitha akteve të miratuara nga kryetari dhe kuvendi i komunës në muajin paraprak deri më datë 10 të çdo muaji;
- Është përgjegjës për publikimin e akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës në ueb-faqen zyrtare të komunës në gjuhë zyrtare;
- Trajton çështjet tjera që janë në kompetencë të përcaktuara me legjislacionin për vetëqeverisje lokale dhe ligjet sektoriale të cilat ndërlidhen me mandatin ligjor të Kryetarit të Komunës.

Përfundimi i mandatit të kryetarit të komunës

Në pajtim me ligjet e zbatueshme për qeverisje lokale dhe zgjedhjet në Republikën e Kosovës, mandati i kryetarit të komunës përfundon në rastet në vijim:

- pas përfundimit të mandatit të tij ligjor;
- në rast të vdekjes;
- nëse jep dorëheqje;
- nëse ndërron vendbanimin në një komunë tjetër;
- nëse nuk paraqitet në punë për më shumë se 1 muaj pa arsye;
- nëse shkarkohet nga detyra në pajtim me ligjin;
- në rast të vendimit përfundimtar të gjyqit që e privon kryetarin e komunës nga zotësia juridike;
- në rast të dënimit për vepër penale me një urdhër për burgim për gjashtë (6) muaj ose më tepër.

5. Korniza ligjore që rregullon zhvillimin e buxhetit komunal

Hapat e përgatitjes së buxhetit komunal

Ligji Për Buxhetin vjetori miratuar nga Kuvendi i Kosovës paraqet ndarjen e buxhetit për të gjitha organizatat buxhetore, përfshirë komunat, dhe iu jep organizatave buxhetore autorizim për të shpenzuar apo transferuar fondet publike, deri në një kufi të caktuar dhe për qëllime specifike, gjatë një viti të caktuar fiskal. Organi përgjegjës për t'iu ndihmuar komunave në përmbushjen e obligimeve të tyre që ndërlidhen me buxhetin është Njësia për Buxhet Komunal pranë Departamentit të Buxhetit në Ministrinë e Financave.

Komunat e Kosovës kanë të drejtë, brenda kufizimeve të politikave ekonomike të Kosovës dhe me qëllim të arritjes së qëndrueshmërisë fiskale, që t'i kenë burimet e veta adekuate financiare të cilat mund të shpenzohen sipas asaj që komunat mendojnë se është e përshtatshme për zbatimin e kompetencave komunale. Burimet financiare të Komunës përbëhen nga të hyrat vetanake, grantet operative nga Qeveria e Kosovës, grantet për kompetencat e shtuara, transferet për kompetencat e deleguara, grantet e jashtëzakonshme, asistenca financiare nga Beogradi, dhe të hyrat nga huamarrja komunale. Kuvendi komunal dhe administrata kanë të drejtë dhe kompetenca që në mënyrë autonome të rregullojnë dhe menaxhojnë burimet financiare nga grantet e nivelit qendror apo ato të grumbulluara nga të hyrat vetanake.

Si ekzekutivi ashtu edhe legjislativi i strukturave qeverisëse komunale kanë detyra dhe përgjegjësi legjislative vis-à-vis zhvillimit dhe miratimit të buxhetit vjetor komunal. Nga ana e ekzekutivit, është përgjegjësi e kryetarit të komunës që ta propozojë buxhetin komunal tek kuvendi i komunës për miratim si dhe ta ekzekutojë buxhetin e miratuar. Nga ana e legjislativit, komiteti për politika dhe financa, komiteti i përhershëm për legjislacion, është përgjegjës për rishikimin e *ndër të tjera*, Kornizës Afatmesme të Buxhetit dhe buxhetit vjetor. Të dy dokumentet duhet të miratohen nga kuvendi komunal i cili është organi më i lartë përfaqësues në komunë. Në fakt, kuvendi komunal nuk mund ta delegojë përgjegjësinë e vet për asnjë vendim që ka të bëjë me miratimin e buxhetit komunal, dhe kuvendi komunal konsiderohet si 'jofunksional' nëse ai dështon që ta miratojë buxhetin e propozuar komunal brenda afatit kohor të paraparë me ligj. Në fund, derisa legjislacioni që ka të bëjë me buxhetin nuk i cakton komitetit të komuniteteve rol shqyrtues apo miratues të dokumenteve të lartpërmendura buxhetore, komiteti është i mandatuar që t'i shqyrtojë të gjitha politikat komunale, praktikat dhe aktivitetet për të siguruar respektim të të drejtave të komuniteteve joshumicë.

Korniza ligjore i parasheh disa hapa konkret të cilët duhet të respektohen gjatë zhvillimit dhe miratimit të buxhetit vjetor komunal. Ligji për Menaxhim të Financave Publike dhe Llogaridhënie i parasheh kriteret kryesore, derisa hapat specifik janë elaboruar në Qarkoren Buxhetore e cila nxirret nga Ministria e Financave. Afatet kryesore janë si në vijim:

1. 30 prill - Deri më 30 prill të secilit vit kalendarik, qeveria duhet t'ia dorëzojë Kuvendit Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) për vitin e ardhshëm fiskal si dhe vlerësimet për dy vitet e ardhshme fiskale. Përmbajtja e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve është specifikuar në legjislacion.

2. 15 Maj – Ministri duhet të nxjerr qarkoren e parë buxhetore deri më 15 maj të vitit aktual fiskal për shefin e zyrave të financave të secilës organizatë buxhetore, përfshirë komunat. Qarkorja Buxhetore ndër të tjera përfshinë, procedurat që duhet të ndiqen nga komuna gjatë përgatitjes së propozim buxhetit, përfshirë edhe afatet; informatat që duhet të paraqiten në buxhetin e saj të propozuar; dhe informatat për vlerësimin e nivelit të granteve dhe kufijve të shpenzimeve. Qarkorja buxhetore ofron udhëzimet fillestare, orarin dhe kufijtë fillestar të financimit për qëllim të përgatitjes së buxhetit të propozuar komunal dhe parashikimin për tri vitet e ardhshme fiskale. Qarkorja buxhetore komunale 2014/01 [ne tekstin e më tutjeshëm Qarkorja Buxhetore] është nxjerrë në maj 2013 nga Ministria e Financave.
3. 30 qershor – Deri në këtë datë, kuvendet komunale duhet ta kenë shqyrtuar, ndryshuar dhe plotësuar, nëse është e nevojshme, dhe miratuar Kornizën afatmesme të buxhetit, si dhe dorëzuar një kopje të atij dokumenti në Ministrinë e Financave dhe publikuar një kopje në të cilën do të kenë qasje edhe publiku. Hartimi i kornizës afatmesme buxhetore, që është përgjegjësi e degës ekzekutive, është hapi i parë në procesin e përgatitjes së buxhetit vjetor. Korniza afatmesme buxhetore përcakton për tre vitet e ardhshme fiskale elementet në vijim: parashikimet dhe supozimet ekonomike dhe buxhetore; një strategji zhvillimore komunale; vlerësimin e përgjithshëm të të ardhurave nga të gjitha burimet; caqet e përgjithshme për shpenzimet dhe vlerësimet e mbështetjes së pritur nga donatorët.
4. 15 gusht – Deri më 15 gusht, nëse është e nevojshme, Ministri nxjerr qarkoren e dytë buxhetore për komunat ku përcaktohen udhëzimet përfundimtare buxhetore me nivelet përfundimtare të granteve, të cilat llogariten sipas Ligjit për financat e pushtetit lokal dhe janë në përputhje me ato të përcaktuara në kornizën afatmesme të shpenzimeve. Ministria e Financave nxori qarkoren buxhetore komunale 2014/02, në korrik 2013.
5. 1 shtator – Deri në këtë datë, kryetari i komunës duhet të paraqesë propozim-buxhetin komunal në kuvendin e komunës. Propozim-buxheti komunal përfshin: parashikimin dhe supozimin ekonomik dhe buxhetor; vlerësimin e përgjithshëm të të ardhurave nga të gjitha burimet; një cak të përgjithshëm për shpenzimet në të gjitha kategoritë ekonomike të shpenzimeve; vlerësimet e mbështetjes së pritur nga donatorët dhe çfarëdo të dhëna të tjera me rëndësi materiale për buxhetin. Me pak fjalë, propozim-buxheti komunal për vitin 2014 do të duhej të përmbante kërkesat për ndarje buxhetore për vitin 2014 dhe një parashikim të hershëm për kërkesat për ndarje buxhetore për vitin 2015 dhe atë 2016. Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë përcakton sanksionet ligjore që shqiptohen nga niveli qendror, duke përfshirë emërimin e një administratori financiar komunal, nëse kryetari i komunës nuk respekton këtë afat.
6. 30 shtator – Deri më 30 shtator, kuvendi i komunës duhet të ketë shqyrtuar, nëse është e nevojshme edhe ndryshuar, miratuar dhe dorëzuar propozim-buxhetin komunal në Ministrinë e Financave. Propozim-buxheti, që është një dokument publik, duhet të shpallet në ueb faqen zyrtare të komunës. Ligji për menaxhimin e financave publike përkrah hapat që ndërmerren

nga Ministri i Financave nëse kuvendi i komunës dështon që me kohë të miratojë dhe ta dorëzojë buxhetin komunal.

Në këtë raport nuk shqyrtohen disa hapa të brendshëm komunal për hartimin e buxhetit, të tillë si rishikimi me prioritet i programeve komunale, caktimi i tavanëve të veçanta për programet fillestare, si dhe nxjerrja e qarkoreve buxhetore të brendshme komunale.

Kërkesat e konsultimit me publikun gjatë procesit të hartimit të buxhetit komunal

Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, si dhe qarkorja buxhetore përcaktojnë format e konsultimit me publikun që duhet të mbahen gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të buxhetit komunal. Ky konsultim me publikun ka për qëllim që të kontribuojë në hartimin e një buxheti komunal që pasqyron nevojat dhe prioritetet e banorëve të komunës, si dhe përkushtimin e komunës ndaj parimeve të qeverisjes së mirë, të tilla si transparenca dhe llogaridhënia:

1. Gjatë hartimit të kornizës afatmesme buxhetore, dega ekzekutive duhet të mbajë konsultime me komunitetet dhe hisedarët kyç, duke përfshirë mbledhjet publike për të diskutuar prioritetet dhe strategjitë.
2. Para miratimit të kornizës afatmesme buxhetore, komiteti për politika dhe financa duhet të mbajë posaçërisht mbledhje publike për të diskutuar prioritetet financiare dhe strategjitë.
3. Para dorëzimit të propozim-buxhetit komunal në kuvendin e komunës, drejtori i financave – në konsultim me kryetarin e komunës – duhet të mbajë mbledhje publike me qëllim të rishikimit dhe kuptimit të propozim-buxheteve nga drejtoritë komunale.
4. Pas dorëzimit të buxhetit në kuvendin e komunës (deri më 1 shtator), kuvendi i komunës duhet të mbajë një apo disa mbledhje publike të paralajmëruara me kohë për të siguruar pikëpamjet e qytetarëve për buxhetin, si dhe për të marrë parasysh dhe rishikuar ato sipas nevojës.

Korniza ligjore përcakton hollësitë për atë se si komunat duhet të njoftojnë banorët për mbledhjet e organeve ligjvënëse (p.sh. të kuvendit komunal dhe të komiteteve të tij), si dhe për mbledhjet publike që organizohen posaçërisht për të siguruar se banorët gëzojnë mundësinë për të marrë pjesë në takimet e tilla.

Ligji për vetëqeverisjen lokale, i plotësuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me anë të Udhëzimit administrativ 2008/09 për transparencën në komuna, përcakton që mbledhjet e kuvendit të komunës dhe komiteteve të tij janë të hapura për opinion. Anëtarëve të publikut u lejohet ndjekja dhe pjesëmarrja në mbledhjet e kuvendit të komunës, ashtu siç parashihet me rregulloren e punës të komunës. Në të vërtetë, mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të kuvendit të komunës dhe të komiteteve të tij janë të hapura për opinion përveç nëse ndërmerret

një veprim i veçantë, më saktësisht votimi me shumicë nga ana e kuvendit a komitetit, për të ndaluar pjesëmarrjen e opinionit për shkak të shqetësimeve të sigurisë ose të privatësisë.

Njoftimi për mbledhjen duhet të shpallet shtatë ditë përpara për mbledhjet e kuvendit të komunës dhe komiteteve të tij. Njoftimi duhet të përmbajë të dhënat për datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, si dhe gjithashtu duhet të përfshijë rendin e ditës dhe çfarëdo materiali gjegjës. Përveç kësaj, njoftimi duhet të respektojë Ligjin për gjuhët. Udhëzimi administrativ përcakton edhe kërkesa të tjera për mbledhjet e kuvendit të komunës dhe komiteteve të tij: njoftimi për opinion duhet të vendoset në vendet më të vizituara brenda territorit të komunës dhe duhet të vendoset në ueb faqen zyrtare të komunës, si dhe duhet të shpallet në shtypin dhe transmetuesit lokal. Për më tepër, kryesuesi i kuvendit të komunës a i komitetit është përgjegjës për të siguruar se kushtet fizike të vendit ku mbahet mbledhja janë të përshtatshme për pjesëmarrjen e opinionit.

Mbledhjet e jashtëzakonshme të organit ligjvënës mbahen sipas të njëjtave kushteve procedurale përkitazi me njoftimin, por në këtë rast njoftimi duhet të shpallet tri ditë pune përpara mbajtjes së mbledhjes. Në lidhje me takimet publike, të cilat dallojnë nga mbledhjet e hapura të organeve legislative, zbatohen të njëjtat kushte për njoftimin, megjithëse njoftimi duhet të shpallet dy javë përpara mbajtjes së takimit.

6. Aktet e Komunës

Ligji për Vetëqeverisje Lokale në Nenin 11 ka përcaktuar se Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës kanë të drejtë të miratojnë akte brenda kompetencave në përputhje me sistemin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovë.

Bazuar në nenin 12 të Ligjit Për Vetëqeverisje Lokale Kuvendi i Komunës miraton:

- statutin e komunës,
- rregulloren e punës,
- rregulloret komunale për zbatimin e përgjegjësi si dhe zbatimin e ligjeve si dha
- akte tjera për funksionimin efikas të komunës.

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nxjerrë:

- urdhëresa dhe
- vendime brenda kompetencave të përcaktuara me ligj.

Të gjitha aktet e nxjerra nga Organet e Komunave duhet të publikohen në ueb faqen zyrtare të komunës dhe në formë fizike në gjuhë zyrtare, gjuhën shqipe dhe gjuhë serbe, si dhe në gjuhë në përdorim zyrtar në komunë ashti siç është përcaktuar me rregulloren Nr. 01/2013 Për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunave të nënshkruar nga Ministri i MAPL-së me datë 34 Janar 2013.

7. Procedura e Miratimit të Statutit të Komunës

Statuti i Komunës është akti kryesor nënligjor që miratohet nga komuna dhe në pajtim me legjislacionin e qeverisë qendrore që rregullon organizimin e brendshëm të komunës.

Sipas nenit 12.3 të Ligjit NR. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti III / Nr. 28 / 04 Qershor 2008), “Statuti i komunës miratohet dhe mund të ndryshohet me, së paku, votim të dy të tretës së anëtarëve të kuvendit të komunës”.

Procedura për draftimin e statutit të Komunës është e rregulluar me Rregulloren Nr.01/2013 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave.

Themelimi i Komisionit Komunal

Në bazë të rregullave të deritanishme të hartimit apo ndryshimit të Statutit të Komunës është praktikuar themelimi i një Komisioni profesional, përgjegjës për zhvillimin dhe mbikëqyrjen e procedurave të hartimit të Statutit të Komunës.

Komisioni kë këtë përbërje:

- anëtarët e Kuvendit të Komunës;
- anëtar të ekzekutivit të komunës;
- zyrtarë të administratës së Komunës;
- anëtar të shoqërisë civile.

Komisioni themelohet nga Kuvendi i Komunës me shumicë të votave të anëtarëve të Komunës.

Procedura e hartimit (draftimit) të Statutit të Komunës

Pas themelimit të Komisionit për mbikëqyrjen dhe zhvillimin e procedurave të hartimit të Statutit, autorizimet për hartimin e draftit të parë të Statutit të Komunës i jepen njësive të mëposhtme komunale, sipas dispozitave të paragrafit 2 të nenit 14 të Rregullores për hartimin e akteve komunale:

- *Zyra Ligjore e Komunës / Zyrtari Ligjor*, përgjegjëse për zbatimin unik të teknikës juridike të hartimit të akteve komunale, si dhe harmonizimin e tyre me legjislacionin primar;
- *Njësia për integrime evropiane e komunës / zyrtari për integrime evropiane*, përgjegjëse për përafrimin e akteve të komunës me legjislacionin e BE-së, që ndërlidhet me vetëqeverisjen lokale;

- **Njësia buxhetore e komunës**, e cila kujdeset për përcaktimin e kostos financiare të aktit të propozuar me rastin e zbatimit së paku për tre vitet e ardhshme,

Konsultimi me publikun

Gjatë procesit të hartimit të Statutit të Komunës, organet komunale janë të obliguara të konsultojnë publikun duke u bazuar në nënparagrafin 1.1 të nenit 14 të Rregullores Nr. 01/2013 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave.

Rekomandimet e marra nga qytetarët dhe grupet e tjera të interesit duhet të shqyrtohen dhe brenda kornizës së lejuar ligjore duhet të implementohen në akt.

Konsultimi paraprak

Gjatë procesit të hartimit të Statutit të Komunës, duke u bazuar në dispozitat e nenit 83 të LVL-së, Komisioni komunal mund të kërkoj këshilla në organin mbikëqyrës për sa i përket ligjshmërisë dhe/ose arsyeshmërisë së aktit në fjalë.

Inicimi i hartimit, ndryshimit dhe plotësimit të Statutit

Subjektet të cilat kanë të drejtën e inicimit të hartimit, ndryshimit apo plotësimit të Statutit të Komunës në bazë të dispozitave të nenit 13 të Rregullores së lartpërmendur janë:

1. Kryetari i Komunës si dhe njësitë administrative komunale.
2. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.
3. Komitetet e Kuvendit të Komunës.
4. Anëtarët e Kuvendit të Komunës.
5. 15% e qytetarëve të Komunës me të drejtë vote.

Hapat paraprak të cilët duhet të ndërmerren për draftimin e Statutit të Komunës janë:

1. Hartimi i projekt-aktit fillestar dhe konsultimi me publikun.
2. Konsultimi i jashtëm i grupeve të interesit dhe qytetarëve.
3. Vlerësimi i ndikimit financiar të aktit të propozuar.
4. Ripunimi i projekt-aktit pas konsultimeve.
5. Shqyrtimi dhe miratimi nga Kuvendi i Komunës.
6. Nënshkrimi i aktit nënligjor komunal, si dhe
7. Dërgimi për konfirmim të ligjshmërisë në ministrinë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale brenda 7 ditëve pas miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe nënshkrimit nga Kryesuesi.

Miratimi i Statutit në Kuvendin e Komunës

Drafi final i Statutit të Komunës, përmes Komisionit komunal duhet të paraqitet për diskutim në Komitetet e Obligueshme (KPF dhe KK). Pas shqyrtimit të draftit nga Komitetet e

obligueshme, propozimi duhet të përfshihet në Rendin e ditës së mbledhjes së kuvendit sipas dispozitave të nenit 47 të LVL-së.

Vlerësimi i Ligjshmërisë

Pas miratimit Statuti i Komunës dërgohet në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal brenda 7 ditëve pas miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe nënshkrimit nga Kryesuesi. Bazuar në nenin 81 pika 4 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal vlerëson ligjshmërinë e statutit të komunës 15 ditë nga pranimi i tij përmes regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës;

Rregullorja e Punës së Kuvendit të Komunës miratohet me shumicën e votave të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, ndërsa rregulloret tjera komunale miratohen sipas procedurës së rregullt me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës përveç nëse ndryshe parashihet me ligj.

Procedura e hartimit të rregulloreve lokale është e njëjtë me procedurën e hartimit të Statutit të Komunës.

8. Procedura e miratimit të simboleve të komunës

Simbolet e komunave miratohen dhe ndryshohen nga Kuvendi i Komunës në pajtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore të Republikës së Kosovës dhe nuk u përngajnë simboleve të shteteve të tjera apo komunave në Republikën e Kosovës apo jashtë saj;

- Simbolet komunave mund të miratohen, apo ndryshohen me dy të tretën (2/3) e votimit të kuvendit të komunës, pas konsultimit publik gjithëpërfshirës;
- Emri i komunës brenda kornizës së logos duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe serbe dhe në gjuhë tjetër e cila është gjuhë zyrtare në atë komunë;
- Simbolet e komunave duhet të përfshijë shenjën dhe emrin e komunës;
- Simbolet e komunës duhet të shprehin karakteristikat dhe veçoritë e komunës;
- Simboli nuk duhet të nxisë urrejtje apo ndarje nacionale ndërmjet komuniteteve në Kosovë;
- Simbolet duhet të respektojnë parimin e multietnicitetit të asaj komune;
- Simbolet nuk duhet të ketë konotacione ideologjike, religjioze apo nacionale;
- Simbolet duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe e pranueshme për të gjitha komunitetet e Komunës;

Procedura për përzgjedhjen e simboleve në komunë

- Kuvendi i Komunës themelon komisionin për zgjedhjen e simbolit të komunës;
- Përbërja e komisionit duhet reflektojë përfaqësimin e të gjitha komuniteteve që jetojnë në komunë;
- Komisioni përpilon kriteret për dizajnimin e simbolit komunal;
- Aplikacioni duhet të dorëzohet dhe të vlerësohet në mënyrë anonime;
- Komisioni komunal, përgatit një listë të ngushtë pasi të kryhet procesi i selektimit;
- Komisioni bën konsultime të gjera publike lidhur me propozimet të cilat janë në listën e ngushtë;
- Bazuar në kriteret e përcaktuara, Kuvendi i Komunës bën ftesa publike për të aplikuar për dizajnimin e simbolit komunal;
- Komisioni bënë përzgjedhjen e simbolit dhe i propozon Kuvendit të Komunës për aprovim;
- Kuvendi i Komunës i shqyrton rezultatet e komisionit dhe të konsultimeve publike dhe e miraton simbolin e komunës me votimin e 2/3 e anëtarëve të Kuvendit të Komunës;

9. Procedura e emërimit të drejtorëve të drejtorive komunale

Emërimi i Drejtorëve të Drejtorive në Komuna është përcaktuar në nenin 62 të Ligjit Nr.03-L/040 për Vetëqeverisje Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/ 2008). Procedura për emërimin e Drejtorëve në Komuna sipas dispozitave të nenit 61 të LVL-së është rregulluar si në vijim:

- Bazuar në paragrafin 1 të nenit 62 të LVL-së, Administrata komunale organizohet në drejtorate;
- Sipas paragrafit 2 të nenit 62 të LVL-së, çdo drejtorat komunal menaxhohet nga drejtori i cili emërohet dhe shkarkohet nga Kryetari;
- Sipas paragrafit 3 të nenin 62 të LVL-së, drejtorët menaxhojnë dhe udhëheqin drejtoratin e tyre në përputhje me udhëzimet strategjike dhe politike të Kryetarit dhe në pajtim me ligjet dhe rregulloret komunale në fuqi;
- Sipas paragrafit 4 të nenin 62 të LVL-së Drejtorët i raportojnë rregullisht Kryetarit për çështjet që janë nën përgjegjësinë e tyre dhe i ofrojnë atij të gjitha informatat dhe raportet e nevojshme për procesin e vendimmarrjes;

Themelimi i Drejtorive Komunale

Deri në miratimin e Statutit të Komunës Kryetari i Komunës me qëllim të ushtrimit të kompetencave ligjore mund të emrojë drejtorët e drejtorive komunale, përfshirë:

- Drejtorin e financave dhe shërbimeve të përbashkëta;
- Drejtorin e arsimit, kulturës, rinisë dhe sportit
- Drejtorin e shërbimeve publike dhe infrastrukturë lokale;
- Drejtorin e mirëqenies sociale, dhe shëndetësisë;
- Drejtorin e planifikimit urban, kadastër dhe inspeksion; si dhe

Numri i drejtorive komunale caktohet në bazë të Statutit të Komunës, ndërsa organizimi i brendshëm i administratës komunale nëpër drejtori rregullohet në bazë të Rregullores mbi organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës.

Drejtorët komunal zakonisht emërohen në mandat të njëjtë me mandatin e Kryetarit i cili edhe i emëron, por Kryetari ka mandat që drejtorët të shkarkoj edhe para përfundimit të mandatit në çdo moment që vlerëson se performanca e drejtorit përkatës nuk është e kënaqshme, apo ka bërë shkelje të detyrave të punës.

Gjithashtu drejtori komunal mund të lirohet nga detyra edhe në bazë të kërkesës së tij për arsye të ndryshme.

10. Mbikëqyrja e ligjshmërisë dhe roli i MAPL-së

Mbikëqyrja e ligjshmërisë dhe roli i MAPL-së

Bazuar në nenin 76 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokal Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është autoritet për mbikëqyrjen e komunave, nëse përgjegjësia për mbikëqyrje nuk i jepet me ligj të veçantë ndonjë ministrie tjetër.

Objektivat e shqyrtimit administrativ të komunave përfshijnë:

- forcimin e organeve të vetëqeverisjes lokale në përmbushjen e përgjegjësiave të tyre përmes këshillimit, mbështetjes dhe ndihmës;
- të sigurojë ligjshmëri të aktiviteteve të organeve të vetëqeverisjes lokale;
- të sigurojë që të drejtat dhe interesat e qytetarëve të respektohen;

Shqyrtimi i funksionimit të komunave

Bazuar në nenin 79 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, shqyrtimi i funksionimit të komunave në fushën e kompetencave vetanake dhe të zgjeruara kufizohet me shqyrtimin e ligjshmërisë, ndërsa shqyrtimi administrativ në fushën e kompetencave të deleguara i nënshtrohet mbikëqyrjes së ligjshmërisë dhe përshtatshmërisë së veprimeve

Llojet e shqyrtimit të Akteve të Komunave:

- Shqyrtimi i rregullt i ligjshmërisë;
- Shqyrtimi i detyrueshëm i ligjshmërisë (aktet e përgjithme të miratuara nga kuvendet e komunave, vendimet lidhur me aktivitetet e përbashkëta të partneriteteve për bashkëpunim si dhe aktet e miratuara brenda kornizës së implementimit të kompetencave të deleguara);
- Shqyrtimi i përshtatshmërisë.

Publiciteti i shqyrtimit administrativ

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal i dorëzon Qeverisë së Kosovës dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës raportin vjetor të aktiviteteve të saj lidhur me mbikëqyrjen e komunave.

Roli i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal

Doracak për Inaugurimin dhe Funkcionalizimin e Organeve të Komunës

Kompetencat e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal janë përcaktuar në Shtojcën 12 të Rregullorës së Qeverisë Nr. 02/2011 Për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, që përfshijnë:

- Zhvillon politika dhe zbaton legjislacion për vetëqeverisje efikase komunale;
- Promovon dhe afirmon të drejtën e organeve lokale për vetëqeverisje në pajtim me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale;
- Bashkërendon dhe promovon zhvillimin e e reformës së pushtetit lokal;
- Bashkërendon dhe përkrahë bashkëpunimin ndër-komunal dhe ndërkufta;
- Promovon zhvillimin e shërbimit civil komunal profesional, duke i marrë parasysh përgjegjësitë e Ministrisë së Administratës Publike;
- Ndihmon organet e vetëqeverisjes lokale në zhvillimin e buxheteve dhe sistemeve të tyre të menaxhimit të financave;
- Mbikëqyrë cilësinë e shërbimeve komunale;
- Identifikon dhe zhvillon programe për ngritjen e kapaciteteve institucionale të organeve të vetëqeverisjes lokale;
- Punon për promovimin dhe zhvillimin e transparencës së organeve të vetëqeverisjes lokale;
- Ofron këshilla dhe udhëzime ligjore për komunat;
- Bashkërendon aktivitetet e agjencive ndërkombëtare dhe organizatave joqeveritare që kanë të bëjnë me komunat;
- Bashkërendimi me ministritë sektoriale për avancimin e vetëqeverisjes lokale;
- Mbikëqyrja e komunave gjatë zbatimit të përgjegjësive dhe kompetencave të zgjeruara dhe të deleguara;
- Bashkërendimi me Ministrinë e Financave për t'u siguruar se administratat komunale marrin mjetet buxhetore që u duhen për t'i ushtruar përgjegjësitë e veta, duke përfshirë investimet publike;
- Kontribuon në respektimin dhe promovimin e të drejtave të njeriut nga organet e vetëqeverisjes lokale;
- Krijon politika për nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimarrjes në nivelin lokal.